



WORLD BANK GROUP

RAPORTI I RREGULLT EKONOMIK PËR BALLKANIN PERËNDIMOR
Nr.20 | Vjeshtë 2021

KOSOVA

RIMËKËMBJE E GJELBËR - SHËNIMET PËR SHTETE



Kosova

- Ekonomia e Kosovës po rimëkëmbet me hapa të shpejtë nga pandemia COVID-19, dhe deri në fund të vitit 2021 pritet që prodhimi i brendshëm bruto të tejkalojë nivelin e vitit 2019, megjithatë rreziqet për perspektivën mbeten të larta pasi vendi vijon përpjekjet në luftën kundër pandemisë.
- Aktiviteti ekonomik në vitin 2021 pritet të zgjerohet me 7.1 për qind si rezultat një rikuperimi më të fortë se sa pritej në numrin e vizitorëve nga diaspora, rikthimit të besimit të konsumatorit dhe rritjes së nivelit të kredive konsumatore. Eksportet e mallrave vijuan të zgjerohen dhe diversifikohen gradualisht krahasuar me vitin 2020.
- Megjithatë, presionet e forta inflacioniste, kryesisht nga rritja e çmimeve të importit, mund të minojnë një rikuperim më të fortë të investimeve private.
- Të ardhurat publike po përjetojnë një rikuperim të paprecedentë për shkak të zgjerimit të aktivitetit ekonomik, por edhe për shkak të inflacionit më të lartë dhe masave të rritjes së pajtueshmërisë tatimore. Si rezultat, dhe në kushtet e ekzekutimit të ngadaltë të investimeve publike, deficitit fiskal pritet të ulët në 2021.
- Menaxhimi i valës së katërt të pandemisë, përfshirë përsheptimin e procesit të vaksinimit, mbetet një prioritet për të ardhmen e afërt. Në planin afatmesëm, Kosova duhet të kalojë në një model rritjeje ekonomike më të orientuar drejt produktivitetit.

Zhvillimet e Fundit Ekonomike

Kosova po përjeton një rimëkëmbje shumë më të fortë se sa pritshmëritë. Pas rikthimit në vlera pozitive modeste në tremujorin e fundit të vitit 2020, rritja ekonomike mori hov gjatë tremujorit të parë (TM1) të vitit 2021, duke arritur në 5.6 për qind.¹ Shitjet e bizneseve dhe flukset tregtare deri në korrik 2021 tejkaluan nivelet e vitit 2019, duke sugjeruar një përsheptim të mëtejshëm të rritjes ekonomike për pjesën e mbetur të vitit. Me përsheptimin e proceseve të vaksinimit në Evropë dhe Kosovë, aktiviteti ekonomik tani parashikohet të zgjerohet me 7.1 për qind në 2021, rritje me 3.1 pikë përqindje nga parashikimi i kryer në pranverë. Eksportet dhe konsumi privat pritet të japin kontributin më të lartë në rritjen ekonomike. Investimet private gjithashtu pritet të ndikojnë pozitivisht në normën e rritjes

ekonomike. Nga ana e prodhimit, shërbimet vijnë të jenë nxitësi kryesor i rritjes, ndërsa kontributi i bujqësisë mbetet i ulët.

Ndikimin më të madh në përsheptimin e rimëkëmbjes e ka dhënë rritja e vizitave nga diaspora e cila ka nxitur eksportet e shërbimeve të Kosovës dhe remitancat informale. Në qershor 2021, eksportet e shërbimeve tejkaluan nivelet e vitit 2019, dhe deri në fund të vitit vlerësohen t'i tejkalojnë këto nivelet me 9.5 për qind. Eksportet e mallrave të tregtisë kanë ruajtur gjithashtu një ritëm të shpejtë rritjeje, por pesha e tyre në prodhimin total mbetet relativisht e ulët në 8.4 për qind.

Kufizimet e pakta në aktivitetin ekonomik, masat mbështetëse fiskale dhe rritja e fortë e kredisë kanë forcuar konsumin privat. Masat e kufizuara të kontrollit ndaj pandemisë deri në fund të gushtit 2021 mundësuan rirfillimin e pandërprerë të aktivitetit ekonomik

1 Të gjitha krahasimet janë në terma vjetorë, përveç rasteve kur deklarohet ndryshe.

dhe, pavarësisht vonesave të konsiderueshme, përmirësimi i qasjes në vaksina ka rritur besimin e biznesit dhe të konsumatorit. Përveç transfertave sociale dhe subvencioneve të shënjestruara të pagave, lejimi i tërheqjes së një pjese të kursimeve të pensionit duke filluar nga fundi i vitit 2020, të cilat arrijnë në gati 3 për qind të PBB-së, ka të ngjarë të ketë rritur konsumin privat, veçanërisht gjatë TM1 të 2021. Rritja e konsiderueshme e kredive për familjet, e cila arriti në 16.2 për qind në korrik 2021, gjithashtu solli forcim të konsumit privat.

Rimëkëmbja e ekonomisë është shoqëruar me rritje të punësimit formal. Sipas Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, numri mesatar tremujor i kontribuesve aktivë të pensioneve u rrit me 13.6 për qind gjatë TM2, duke evidentuar një rritje prej rreth 40,000 të të punësuarve në vende pune formale në krahasim me të njëjtën periudhë në vitet 2020 dhe 2019. Në të njëjtën kohë, numri mesatar tremujor i punëkërkuësve të regjistruar pësoi gjithashtu rënie të ndjeshme - me më shumë se 30 për qind në krahasim me të njëjtën periudhë në vitin 2020. Megjithatë, ky tregues vijon të jetë më i lartë se në të njëjtën periudhë të vitit 2019.

Në linjë me trendet globale, presionet inflacioniste u rritën ndjeshëm gjatë vitit 2021, duke krijuar sfida për investimet private. Inflacioni i çmimeve të konsumit, i udhëhequr kryesisht nga rritja e çmimeve të importit, pritet të arrijë një mesatare vjetore afërsisht 3.5 për qind në 2021. Çmimet e importit u rritën me 2.5 për qind në TM1 dhe 7.7 për qind në TM2 dhe ritmet e rritjes pritet të përshpejtohen gjatë pjesës tjetër të vitit, kryesisht për shkak të çmimeve të mallrave të importit. Rritje pësuan dhe çmimet

e prodhimit, të cilat u ndoqën nga një rritje e dukshme e indeksit të çmimeve të ndërtimit (17 për qind gjatë TM2 të 2021), për shkak të rritjes së çmimeve të mallrave dhe pagave. Ndërtimi përbën pothuajse 60 për qind të aktivitetit të investimeve private në Kosovë.²

Eksportet janë duke përjetuar një rikuperim të shpejtë në vitin 2021. Importet pritet të rriten me më shumë se 30 për qind në 2021 për të përballuar rigjallërimin në konsum, eksporte dhe investime, ndërsa eksportet e mallrave pritet të rriten me 35 për qind. Megjithëse norma e rritjes së eksporteve pritet të tejkalojë atë të importeve, duke qenë se rritja e këtyre të fundit bëhet nga një bazë më e lartë, deficit i llogarisë korrente parashikohet të arrijë në 8.5 për qind të PBB-së, krahasuar me 7 për qind në 2020. Në të njëjtën kohë, investimet e huaja direkte, të nxitura nga një nivel më i lartë i riatdhesimit të dividendëve, pritet të ulen nga 4.1 në 3.8 për qind të PBB -së.

Deficiti fiskal pritet të ngushtohet ndjeshëm për shkak të përmirësimit të fortë të performancës në mbledhjen e të ardhurave publike dhe ngadalësimit në realizimin e investimeve publike. Të ardhurat publike pritet të rriten me gati 24 për qind në 2021, falë një rritjeje të konsiderueshme të qarkullimit monetar të firmave dhe rikuperimit të fortë të importeve. Deri në fund të gushtit 2021, mbledhja e të ardhurave publike u rrit me më shumë se 30 për qind, dhe kontribuesit kryesorë për këtë ishin të ardhurat nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe nga akciza, që ka të ngjarë të tejkalojnë parashikimet aktuale të buxhetit. Përveç zgjerimit të aktivitetit ekonomik, në rritjen e të ardhurave kanë ndikuar pozitivisht dhe rritja e inflacionit,

² Sipas Statistikave të Investimeve në Ndërmarrje, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

intensifikimi i procesit të mbledhjes së borxhit tatimor dhe procesi i formalizimit i nxitur nga masat stimuluese fiskale. Qeveria ka shpallur një Paketë ambicioze të Ringjalljes Ekonomike që arrin në 5.7 për qind të PBB-së, kryesisht e përbërë nga shpenzime korrente, dhe që pritet të zbatohet gjatë viteve 2021 dhe 2022. Shpenzimet publike pritet të ulen me 1.8 për qind në krahasim me vitin 2020, kryesisht për shkak të mosrealizimit të shpenzimeve për investime publike. Deficiti fiskal vlerësohet të jetë në nivelin 0.9 për qind e PBB-së; me një rënie të konsiderueshme nga viti i kaluar dhe më i ulët se niveli i planifikuar në buxhetin e 2021. Borxhi publik dhe i garantuar pritet të rritet nga 22.4 për qind e PBB-së në vitin 2020 në 23.2 për qind në 2021. Falë performancës së mirë në mbledhjen e të ardhurave, akumulimi i borxhit të brendshëm do të ngadalësohet dhe rezervat fiskale pritet të shtohen.

Sektori financiar po përjeton rritje të fortë të kredive dhe depozitave. Deri në korrik 2021, rritja e kredive arriti në 12 për qind, ndërsa kreditë për familjet u rritën me 16.2 për qind. Gjatë së njëjtës periudhë, depozitat u rritën me 14.5 për qind, ndërsa depozitat e korporatave të tjera jofinanciare u rritën me 31.7 për qind. Sipas Bankës Qendrore, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit mbeti mbi nivelet e kërkesave rregullatore deri në korrik, ndërkohë që niveli i kredive me probleme pësoi luhatje në intervalin 2.5 dhe 2.7 për qind nga janari deri në korrik 2021. Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë vazhdoi të zgjerojë mbulimin e tij, përfshirë tarifën e garancisë të subvencionuara nga qeveria. Kapitali i këtij fondi pritet të forcohet më tej nga grantet qeveritare.

Perspektiva dhe Rreziqet

Kosova pritet të ketë një rritje ekonomike më të madhe se 4 për qind në periudhën afatmesme, por kjo varet nga rrjedha globale e pandemisë dhe menaxhimi i suksesshëm i saj. Edhe pse rritja pritet të ngadalësohet në vitin 2022 në krahasim me kulmin prej 7.1 për qind në 2021, norma e rritjes ekonomike në periudhë afatmesme do të stabilizohet në potencialin e saj prej 4 për qind. Duke pasur parasysh nivelin e arritur në 2021, eksportet e shërbimeve pritet të rriten, por me një ritëm më të ngadaltë. Në të njëjtën kohë, me stabilizimin e çmimeve ndërkombëtare në periudhë afatmesme, eksportet e mallrave të Kosovës gjithashtu do të përjetojnë ngadalësim të ritmeve të rritjes, por ato do të ruajnë nivelet e arritura gjatë dy viteve të fundit. Investimet private, dhe investimet publike, në veçanti, pritet të rriten dhe të japin një kontribut më të lartë në rritjen ekonomike krahas konsumit. Rritja e kreditimit parashikohet të vijojë të mbështesë rritjen e konsumit privat. Në këtë kontekst, importet parashikohet të rriten më tej; kështu që dhe bilanci i llogarisë korrente pritet të përkeqësohet. Në linjë me tendencat para-pandemisë, eksportet neto pritet të kenë ndikim negativ në normën e rritjes ekonomike. Remitancat parashikohet të ruajnë rritjen e tyre në terma nominalë dhe ato do të vijojnë të jenë burimi kryesor i financimit të deficitit tregtar. Presionet inflacioniste parashikohen të zbehen, dhe inflacioni i çmimeve të konsumit pritet të stabilizohet në një mesatare prej 1.8 për qind.

Deficitet fiskale ka mundësi të rriten për shkak të një përshpejtimi të mundshëm të rritjes së shpenzimeve publike në periudhë afatmesme. Të ardhurat publike dhe shpenzimet publike parashikohet të rriten

mesatarisht me 4 për qind dhe 7.6 për qind në vit respektivisht në periudhë afatmesme, duke çuar në një rritje të nivelit të deficitit fiskal në krahasim me vitin 2021. Rritja e të ardhurave publike do të ngadalësohet, kryesisht për shkak të mungesës së kontribuesve të njëhershëm, të tilla si të ardhurat nga dividendi, dhe për shkak të një ngadalësimi të rritjes së importit dhe inflacionit në krahasim me vitin 2021. Rritja e shpenzimeve publike do të nxitet nga një përshpejtim i realizimit të investimeve publike, por edhe nga rritja e shpenzimeve korrente për shkak të zbatimit të Planit të Ringjalljes Ekonomike. Si rezultat, nivelet e deficitit fiskal pritet të rriten pas vitit 2021, duke arritur mesatarisht në 2 për qind të PBB-së në periudhë afatmesme. Për shkak të disponibilitetit të kufizuar të të ardhurave nga privatizimet në periudhë afatmesme, deficitit parashikohet të finanohet kryesisht përmes borxhit të ri të brendshëm dhe borxhit të jashtëm koncesional. Niveli i borxhit publik dhe të garantuar në raport me PBB-në parashikohet të rritet nga 23.2 për qind në 2021 në 27.8 për qind deri në fund të vitit 2023.


Megjithatë, perspektiva është nën kërcënimin e rreziqeve të konsiderueshme të lidhura me COVID-19. Duke pasur parasysh shtimin e varianteve të reja të virusit dhe tendencave të vaksinimit, si në Kosovë ashtu edhe në nivel global, rreziqet e pandemisë mbeten të larta. Kosova u godit nga një valë e katërt e pandemisë në fund të gushtit 2021, por ritmi i vaksinimeve është përshpejtuar. Duke pasur parasysh varësinë e madhe të Kosovës nga vizitat e diasporës, arritja e objektivit të vaksinimit të 60 për qind të popullsisë deri në fund të vitit mbetet e rëndësishme për zbutjen e rreziqeve të lidhura me pandeminë dhe shmangien e rivendosjes së masave të rrepta kufizuese ndaj aktivitetit ekonomik. Për shkak të pasigurisë së natyrshme

mbi ecurinë e pandemisë, politikëbërësit duhet të kenë plane rezervë, veçanërisht duke pasur parasysh ndikimin e lartë të masave kufizuese në mbledhjen e të ardhurave publike, përbërjen e shpenzimeve dhe financimin. Rivendosja e kufizimeve në udhëtimet ndërkombëtare në vendet pritëse të diasporës gjithashtu mund të ndikojë negativisht në rritjen ekonomike dhe pozicionin fiskal.

Në periudhë afatmesme, ekziston një nevojë urgjente për t'i përqendruar politikat në adresimin e pengesave ndaj rritjes së produktivitetit dhe investimit në kapitalin njerëzor. Për të arritur standarde më të larta jetese dhe zhvillim më gjithëpërfshirës, Kosova duhet të rritet përtej potencialit të saj aktual. Kështu, reformat duhet të fokusohen në (1) përforsimin e stabilitetit makroekonomik dhe qeverisjes së shëndoshë; (2) rritjen e produktivitetit të ndërmarrjeve; (3) rritjen e produktivitetit të fermave; (4) rritjen e kapitalit njerëzor; dhe (5) nxitjen e eksporteve, konkurrencës dhe investimeve private, veçanërisht investimeve të huaja direkte.

Aktiviteti ekonomik në 2021 po rikuperohet më shpejt se parashikimi.


Kontributet në rritjen ekonomike, pikë përqindje



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës; përlogaritje të stafit të Bankës Botërore.

Rikuperimi i fortë i të ardhurave dhe mos-realizimi i shpenzimeve kapitale po ngushtojnë deficitin në 2021.


Për qind e PBB-së



Burimi: Ministria e Financave; përlogaritje të stafit të Bankës Botërore.

Rimëkëmbja po shoqërohet me rritje të fortë të punësimit formal.


Mesatarja tremujore e kontributeve të pensionit



Burimi: Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës.

Eksportet e shërbimeve po përjetojnë një rikuperim të fortë.


Eksportet e mallrave dhe shërbimeve, mln. Euro



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës; përlogaritje të stafit të Bankës.

Presionet inflacioniste u rritën në 2021.


Inflacioni IÇK, në përqindje



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Rritja e kreditimit po mbështet rimëkëmbjen e ekonomisë.

Rritja e kredive, në përqindje



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës.

KOSOVA	2018	2019	2020	2021e	2022f	2023f
Rritja e PBB-së Reale (në përqindje)	3.4	4.8	-5.3	7.1	4.1	4.4
Përbërja (pikë përqindje):						
Konsumi	3.9	6.2	2.2	5.2	2.8	2.7
Investimet	2.6	-1.1	-2.4	1.9	2.3	2.3
Eksportet neto	-3.1	-0.3	-5.1	0.1	-1.0	-0.7
Eksportet	2.5	2.2	-8.4	13.7	2.5	2.2
Importet (-)	5.6	2.5	-3.3	13.6	3.5	2.9
Inflacioni i çmimeve të konsumit (në përqindje, mesatare e periudhës)	1.1	2.7	0.2	3.5	1.8	1.6
Të ardhura publike (për qind e PBB-së)	26.3	26.8	25.4	28.9	28.8	28.8
Shpenzimet publike (për qind e PBB-së)	29.2	29.7	33.0	29.8	30.8	31.0
Prej të cilave:						
Shpenzime për paga (për qind e PBB-së)	8.9	8.7	9.8	8.9	8.9	8.9
Asistencë sociale (për qind e PBB-së)	6.2	6.3	7.7	7.5	7.4	7.1
Shpenzime kapitale (për qind e PBB-së)	7.9	7.5	5.6	5.3	6.4	7.0
Bilanci fiskal (për qind e PBB-së)	-2.9	-2.9	-7.6	-0.9	-2.0	-2.2
Bilanci primar fiskal (për qind e PBB-së)	-2.6	-2.6	-7.2	-0.4	-1.5	-1.6
Borxhi Publik (për qind e PBB-së)	16.4	17.0	22.0	22.7	25.9	27.6
Borxhi publik dhe i garantuar (për qind e PBB-së)	17.0	17.6	22.4	23.2	26.2	27.8
Prej të cililit: I Jashtëm (për qind e PBB-së)	6.2	5.8	7.8	7.8	10.1	11.1
Eksportet e mallrave (për qind e PBB-së)	5.6	5.6	6.9	8.4	8.6	8.8
Importi i mallrave (për qind e PBB-së)	46.7	45.8	44.2	55.9	56.3	57.2
Eksportet neto të shërbimeve (për qind e PBB-së)	12.8	13.1	5.7	14.8	14.0	14.7
Bilanci tregtar (për qind e PBB-së)	-28.2	-27.1	-31.6	-32.7	-33.7	-33.7
Fluksi hyrës i remitancave (për qind e PBB-së)	11.4	11.6	13.8	14.3	14.0	13.6
Bilanci i llogarisë korrente (për qind e PBB-së)	-7.6	-5.6	-7.0	-8.5	-9.6	-9.2
Flukset hyrëse të Investimeve të huaja direkte (për qind e PBB-së)	3.4	2.7	4.1	3.8	4.1	4.5
Borxhi i jashtëm (për qind e PBB-së)	30.5	31.2	37.5	—	—	—
Rritja reale e kredimit privat (në përqindje, mesatare e periudhës)	10.1	7.9	7.6	—	—	—
Kreditë me probleme (përqindje e totalit të kredive, fundi i periudhës)	2.5	2.0	2.7	—	—	—
Norma e papunësisë (në përqindje, mesatare e periudhës)	29.5	25.7	—	—	—	—
Norma e papunësisë e të rinjve (në përqindje, mesatare e periudhës)	55.4	49.4	—	—	—	—
Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës (në përqindje, mesatare e periudhës)	40.9	40.5	—	—	—	—
PBB për frymë (US\$)	4,388	4,432	4,295	4,560	4,757	5,005
Shkalla e varfërisë (në përqindje të popullsisë)	23.2	20.9	23.4	20.9	18.9	17.0

Burimet: Autoritetet e Vendit, Vlerësime dhe parashikime të Bankës Botërore

Shënim: Llogaritjet e shkallës së varfërisë bazuar në harmonizimin ECAPOV duke përdorur të dhënat e ABEF. Vlerat e parashikuara për periudhat aktuale/ të ardhme fillojnë në vitin 2018. Treguesit e të ardhurave të matur sipas AAKJ dhe treguesit e konsumit të matura sipas ABEF nuk janë plotësisht të krahasueshme. Varfëria përkufizohet si jetesa me më pak se 5.5 dollarë/ditë për person të rregulluar sipas PPP të rishikuar të vitit 2011.

Shikoni raportin online:
www.worldbank.org/eca/wbrer

